

461 GRUPI

Fusha përdoret për identifikimin e materialit të lidhur në mënyrë hierarkike në nivelin më të lartë. Regjistrimi, me të cilin është krijuar lidhja, është në nivelin më të lartë, ndërsa regjistrimi, i cili përmban këtë fushë, është në nivelin e ndërmjetëm ose në nivelin e njësisë.

Nënfushat & përsëritshmëria

FUSHA/NËNFUSHA		PËRSËRITSHMËRIA
461	Grupi	nr
	1 <i>Numri identifikues</i>	nr

Treguesit

TREGUESI	VLERA	KUPTIMI
1		<i>Nuk është i përcaktuar</i>
2		<i>Shfaqja e shënimit</i>
	1	<i>Shënimi shfaqet</i>

PËRSHKRIMI I NËNFUSHAVE

4611 Numri identifikues

Në nënfushën 1 shënohet numri identifikues i regjistrimit në nivelin e sipërm, ky është regjistrimi për koleksionin në tërësi.

SHËNIME PËR PËRMBAJTJEN E FUSHËS

Fusha 461 përdoret tek përpunimi i fondeve të trashëguara dhe koleksioneve të krijuara, nëse materialet janë të përpunuara në disa nivele. Plotësohet tek regjistrimet në nivelin e poshtëm dhe të ndërmjetëm.

Lidhja nga njësia ose nëngrupi deri tek grupi gjithmonë ndërtohet nga poshtë lart.

SHEMBUJ

- * COBISS.net

200	1□	a Trashëgimia e Lasgush Poradecit j1920-1987 (Regjistrim në nivelin e parë (ID=nnn).)
-----	----	---

200	1□	a Letërkëmbimi j1920-1987
461	□1	1 <nnn> (Regjistrim në nivelin e dytë (ID=mmm).)

200	1□	a Letra e Azem Shkrelit dërguar Lasgush Poradecit j1962
461	□1	1 <nnn>
462	□1	1 <mmm> (Regjistrim në nivelin e tretë (ID=kkk). Trashëgimia e Lasgush Poradecit është përpunuar në tri nivele. Në nivelin e parë është regjistrimi për trashëgiminë në tërësi (ID=nnn), në të dytin janë regjistrimet për pjesët e veçanta të trashëgimisë (p.sh. ID=mmm), ndërsa në të tretin regjistrimet për njësitë e veçanta (p.sh. ID=kkk). Në të gjitha regjistrimet në nivelin e dytë dhe të tretë plotësohet fusha 461 për lidhjen me regjistrimin në nivelin e sipërm. Në regjistrimet në nivelin e tretë plotësohet edhe fusha 462 për lidhjen me regjistrimin në nivelin e dytë.)